

BASHKIA KAVAJE
Njoftim për dhënie me qira

Për dhënien me qira të sipërfaqes së fondit pyjor prej 200 m2, pjesë e pasurisë nr. 111/256 vol. 39 faqe 7, Z.K. 2291 Kryemëdhenj, në administrim të Bashkisë Kavajë”

1.Autoriteti Qiradhënës: Bashkia Kavajë

Adresa: Rruga "Josif Budo", Ndërtesa Nr. 10,
 Email: www.kadastra.bashkiakavaje@gmail.com
 Tel: [055245555](tel:055245555)

2. Të dhënat për sipërfaqen: Sipërfaqja se fondit pyjor prej 200 m2, pjesë e sipërfaqës prej 31 256 m2 e pasurisë nr. 111/256 vol. 39 faqe 7, Z.K. 2291 Kryemëdhenj, në administrim të Bashkisë Kavajë”

3. Qëllimi i dhënies me qira: me qëllim ushtrimin e veprimtarisë së pushimit.

4. Afati i dhenies me qira: është 4 (katër) muaj, duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës.

5. Vlera dysheme per detyrimin e qirase: është 180 000 leke/ha/vit kalendarik

6. Konkurimi per marrjen me qera do te kryhet ne ambientet e Bashkisë Kavajë në sallën e mbedhjes të Këshillit Bashkiak me datë 30.07.2020 ne oren 11:00.

7. Pikët vlerësuese do të jenë:

Nr.	Lloji i Kriterit	Pesha e matur në pike e kriterit vlerësues (e shprehur në pikë)
1.	Projekti teknik i veprimtarisë që do të ushtrohet, i cili përmban hartën topografike me koordinatat e sipërfaqes objekt përdorimi në variantin PDF dhe në format elektronik në shkallë 1:10000 ku të jenë evidentuar elementet kryesore, si: kufijtë natyrorë, relievi, objektet aktuale, si dhe çdo planimetri tjetër në shkallë më të detajuar, hartuar konform kërkesave të projektit	20 pikë
2.	Planbiznesi dhe investimet që do të bëhen	15 pikë
3.	Planin e rehabilitimit të sipërfaqes	25 pikë
4.	Nivelin e punësimit në veprimtari	5 pikë
5.	Masën e qirasë për ha/vit	35 pikë

8. Kushtet e pjesëmarrjes në konkurrim janë:

a) garanci financiare të mjaftueshme për përballimin e investimeve të parashikuara në planbiznes;

b) të ketë të kontraktuar një specialist të fushës, ku në CV-në profesionale të tregohet përvoja në fushën e veprimtarisë;

c) vërtetim nga organet përkatëse shtetërore se subjekti nuk ka procese gjyqësore në ngarkim, hetim në proces, detyrime tatimore ose detyrime të tjera ndaj të tretëve (vertetim te gjendjes gjyqësore, vertetim nga prokuroia, gjykata, drejtoria rajonale tatimore etj.)

9. Dokumentacioni i nevojshëm:

a. Kërkesën e subjektit për marrjen me qira të pasurisë shtetërore, së bashku me të dhënat për gjeneralitetet e tyre

b. Ekstraktin e regjistrimit në QKR për objektin e veprimtarisë;

c. Projektin teknik të hartuar nga specialistë të licencuar ku janë trajtuar të gjitha elementet e nevojshme për zhvillimin e veprimtarisë së kërkuar;

- d. Planbiznesin dhe investimet që do të bëhen;
- e. të dhëna për kapacitet teknike, stafin, makineritë dhe pajisjet që zotëron;
- f. planin e rehabilitimit të sipërfaqes dhe kthimin e saj në gjendjen e mëparshme;
- g. nivelin e punësimit në veprimtari;
- h. lejen mjedisore për aktivitetin e kërkuar;
- i. çmimin e qirasë së ofruar për ha/vit;
- j. adresën e subjektit, telefon, email dhe faks;

10. Dokumentacion duhet të paraqitet në zarf të mbyllur, të nënshkruar nga konkurruesi me mbishkrimin “Ofertë për dhënie me qira“, dhe i dorëzohen komisionit të posaçëm për vlerësimin e dokumentacionit, në orën e hapjes së procedurës së konkurrimit.

Mosparaqitja e njërit prej dokumenteve të mësipërme përbën kusht skualifikues.

Ofertat dorëzohen nga konkurrenti/ët e interesuar, fizikisht me postë ose dorazi në vendin e përcaktuar për zhvillimin e konkurrimit.

Data e

zhvillimit të konkurrimit: 30.07.2020, ora 11.00, në ambientet e Bashkisë Kavajë në sallën e mbedhjes të Këshillit Bashkiak

Afati i fundit kohor për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje: datë 30.07.2020, ora 11.00